



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 4: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2017



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 4: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2017



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Janar, 2018

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-ës
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

P a r a t h ë n i e

Zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit e kanë transformuar shoqërinë moderne në një "shoqëri informacioni". Karakteristika e tij kryesore është se teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit luajnë rolin më të rëndësishëm në prodhim dhe ekonomi, si dhe në të gjitha sferat e tjera të jetës së individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Duke njohur rëndësinë e këtyre teknologjive, Agjencia e Statistikave të Kosovës kryer një pilot anketë në vitin 2016 mbi përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në ekonomitë familjare dhe individuale. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte testimi i metodologjisë, instrumenteve si dhe përgatitja për zhvillimin e kësaj ankete TIK të rregullt.

Në vitin 2017, njësia e Standardit jetësor pranë ASK-së ka implementuar anketën lidhur me përdorimin e TIK të rregullt sipas metodologjisë së Eurostatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke përfshirë ekonomitë familjare si dhe individët e kategorisë 16-74 vjeç. Periudha e referencës ishte tre muaj përpara si dhe intervista ka qenë drejtpërdrejt.

Anketa në ekonomitë familjare është kryer në një mostër prej dy fazave. Në fazën e parë janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme qarqet regjistruese që janë të shpërndara sipas rajonit dhe sipas zonave urbane dhe rurale në tërë territorin e Kosovës, ndërsa në fazën e dytë janë zgjedhur në mënyrë sistematike ekonomitë familjare për çdo qark. Madhësia e mostrës ka qenë 3750 ekonomi familjare dhe 3750 individë.

Përkrahje profesionale për zhvillimin e anketës së TIK, 2017 ka ofruar GOPA nëpërmjet projektit të Eurostatit, IPA 2014 ku falënderojmë ekspertët e këtyre organizatave për kontributin e tyre.

Për zhvillimin e kësaj ankete kanë kontribuar edhe stafi tjetër i ASK-së në nivel rajonal, me këtë rast falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale që kanë kontribuar në grumbullimin e të dhënave të anketës TIK.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato mund të dërgohen në adresën elektronike: infoask@rks-qv.net.

Avni Kastrati – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
Naime Rexhepi – Shefe e divizionit të Statistikave Sociale.

Publikimin përgatitën:

Emina Deliu – Zyrtare e lartë e sektorit të statistikave të Standardit Jetësor,
Besa Haqifi – Zyrtare e lartë e statistikave të Standardit Jetësor,
Hydai Morina – Zyrtar i statistikave të Standardit Jetësor,
Drita Sylejmani – Zyrtare e lartë në sektorin e shpërndarjes.

Janar, 2018

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave

TIK	-	Teknologjia Informative dhe të Komunikimit
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
GOPA	-	Kompani e pavarur private këshilluese
IPA	-	Instrumenti për Ndhmën e Para - Anëtarësimin
BE	-	Bashkimi Evropian
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale

Përmbajtja


Faqe

1 Qasje në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në ekonomitë familjare	4
1.1.Qasje në kompjuter në shtëpi	4
1.2.Qasje në internet në shtëpi	4
1.3 Lloji i qasjes në internet.....	5
2 Përdorimi i kompjuterit nga individët të moshës 16-74 vjeç	6
2.1.Përdorimi i kompjuterit herën e fundit	6
2.2.Përdorimi i kompjuterit gjatë tre muajve të fundit.....	6
3 Përdorimi i internetit nga individët e moshës 16-74 vjeç	7
3.1.Përdorimi i internetit herën e fundit	7
3.2.Përdorimi i internetit gjatë tre muajve të fundit.....	7
3.3.Përdorimi i pajisjeve elektronike për tu qasur në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë tre muajve të fundit	8
4 Përdorimi i E-Qeverisë.....	9
4.1.Përdorimi i internetit për qëllime private gjatë 12 muajve të fundit	9
5 Konkluzione	10

1 Qasje në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në ekonomitë familjare

1.1. Qasje në kompjuter në shtëpi


Graf 1. Ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në kompjuter në shtëpi, 2017, %



Në vitin 2017 ekonomite familjare në Kosovë kanë pasur qasje në kompjuter 61,3%, ndërsa 38,7% janë deklaruar se nuk kanë pasur qasje në asnjë lloj kompjuteri (p.sh. desktop, laptop, netbook, tablet, duke përfshirë telefonat e mençur).

1.2. Qasje në internet në shtëpi


Graf 2. Ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi, 2017, %



Siç është pritur, shumica prej 88,8% të ekonomive familjare kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo lloj pajisje.

1.3 Lloji i qasjes në internet

Graf 3. Lloji i qasjes në internet në ekonomitë familjare, 2017, %




Prej 88,8% të ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet përmes linjës fikse dhe mobile, 83,65% janë shërbyer me linjën fikse, ndërsa 24,66% me linjën mobile.

Intervistuarit janë pyetur për linjen broadband si psh. DSL, ADSL, VDSL, internet kabllor, internet satelitor, rrjete Wi-Fi. Më linjen mobile është përfshirë linja përmes rrjetit të telefonisë mobile, në 3G, 4G, LTE (p.sh. UMTS), duke përdorur (SIM) kartë, USB, telefon celular ose telefonin e mençur.

2 Përdorimi i kompjuterit nga individët të moshës 16-74 vjeç


2.1. Përdorimi i kompjuterit herën e fundit

Graf 4. Individët në ekonomitë familjare në Kosovë që kanë përdorur kompjuterin në shtëpi, në punë ose në ndonjë vend tjetër, %



2.2. Përdorimi i kompjuterit gjatë tre muajve të fundit

Graf 5. Shpeshtësia e përdorimit të kompjuterit nga individët në ekonomitë familjare gjatë tre muajve të fundit, %




Prej 38,7% e individëve të cilit kanë përdorur kompjuterin gjatë tre muajve para intervistës, 25,3% kanë përdorur kompjuterin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë.

3 Përdorimi i internetit nga individët e moshës 16-74 vjeç

3.1. Përdorimi i internetit herën e fundit


Graf 6. Individët në ekonomitë familjare në Kosovë që kanë përdorur internetin në shtëpi, në punë ose në ndonjë vend tjetër, %



Të dhënat në grafën e sipërm tregojnë qartë për përdorimin intensiv të internetit. 82,9% e individëve kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, ndërsa 13% e individëve janë deklaruar se asnjëherë nuk e kanë përdorur internetin.

3.2. Përdorimi i internetit gjatë tre muajve të fundit


Graf 7. Shpeshtësia e përdorimit të internetit nga individët në ekonomitë familjare gjatë tre muajve të fundit, %



Prej 82,9% e individëve të cilët kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, 75,7% kanë përdorur internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë.

3.3. Përdorimi i pajisjeve elektronike për tu qasur në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë tre muajve të fundit

Graf 8. Mënyra e përdorimit të telefonit mobil ose telefonit të mençur për tu qasur në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë tre muajve të fundit




Përdorimi i internetit nëpërmjet rrjetit Wi-Fi është pothuajse dyfish më i madh sesa nëpërmjet rrjetit të telefonisë mobile (3G, 4G, LTE).

4 Përdorimi i E-Qeverisë


4.1. Përdorimi i internetit për qëllime private gjatë 12 muajve të fundit

Graf 9. Përdorimi i internetit për disa aktivitete në autoritetet qeveritare ose shërbime publike, për qëllime private gjatë 12 muajve të fundit, %



Çdo i pesti individ ka përdorur internetin për qëllime private për aktivitete në autoritetet qeveritare ose shërbime publike, gjatë 12 muajve të fundit.

Graf 10. Arsyet për mos blerje ose porositje të çfarëdo mallra apo shërbime për përdorimin tuaj privat nëpërmjet internetit gjatë 12 muajve të fundit, %



Vërehet se vazhdon tradita e preferimit të blerjes së drejtpërdrejt në dyqan me 54,6%.

5 Konkluzione

Zhvillimi i shpejtë i përdorimit të Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit vërehet edhe nga rezultatet e anketës TIK 2017.

Në vitin 2017 ekonomite familjare në Kosovë kanë pasur qasje në kompjuter 61,3%, ndërsa 38,7% janë deklaruar se nuk kanë pasur qasje në asnjë lloj kompjuteri (p.sh. desktop, laptop, netbook, tablet, duke përjashtuar telefonat e mençur). (Graf 1)

Siç është pritur, shumica prej 88,8% të ekonomive familjare kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo lloj pajisje. (Graf 2)

Prej 88,8% të ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet përmes linjës fiks dhe mobile, 83,65% janë shërbyer me linjën fiks, ndërsa 24,66% me linjën mobile. (Graf 3)

Prej 38,7% e individëve të cilit kanë përdorur kompjuterin gjatë tre muajve para intervistës, 25,3% kanë përdorur kompjuterin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë. (Graf 5)

Të dhëna në graf 6 tregojnë për përdorimin intenziv të internetit. 82,9% e individëve që kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, ndërsa 13% e individëve janë deklaruar se asnjëherë nuk e kanë përdorur internetin.

Prej 82,9% e individëve të cilit kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, 75,7% kanë përdorur internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë. (Graf 7)

Përdorimi i internetit nëpërmjet rrjetit Wi-Fi është pothuajse dyfish më i madh sesa nëpërmjet rrjetit të telefonisë mobile (3G, 4G, LTE). (Graf 8)

Çdo i pesti individ ka përdorur internetin për qëllime private për aktivitete në autoritetet qeveritare ose shërbime publike, gjatë 12 muajve të fundit. (Graf 9)

Vërehet se vazhdon tradita e preferimit të blerjes së drejtpërdrejt në dyqan me 54,6%. (Graf 10)

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
 - **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 104
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
 - **Fax::** +381 (0) 38 235 033
 - **E-mail:** infoask@rks-gov.net.
- Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>